



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2022:087568

Datë: 14.07.2022

Numri i dokumentit: 03229525

P.nr.271/2022

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Rrahman Beqiri, me procesmbajtëse Atdhetare Bashota Krasniqi, në çështjen penale kundër të pandehurit: M.S., për shkak të veprës penale: Vjedhja e shërbimeve, nga neni 314, par.6, e lidhur me par.1, të Kodit nr.06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës (tutje: KPRK), sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.607/2022 (2022:0021739), të datës 29.04.2022, jashtë seancës, duke vendosur sipas kërkesës - thirrjes se Gjykatës, të datës 26.05.2022, për plotësim dhe korrigjim e aktakuzës, e në mbështetje të nenit 442, par. 4, të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPP), më datë 14.07.2022, nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

1. HUDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.607/2022 (2022:0021739), e datës 29.04.2022, kundër të pandehurit: M.S., “data e lindjes”..., në Mitrovicë, ku edhe tani jeton, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, për veprën penale: Vjedhja e shërbimeve, nga neni 314, par.6, e lidhur me par.1, të KPRK-së, për shkak të mos PLOTËSIMIT DHE KORIGJIMIT të aktakuzës PP.II.nr.607/2022 (2022:0021739), të datës 29.04.2022 nga ana e Prokurorit të Shtetit.
2. Prokurori i Shtetit ka të drejtën ligjore që pas plotësimit të lëndës të parashtroj aktakuzë të re, në respektim të dispozitave ligjore të Kodit të Procedurës Penale.
3. Shpenzimet e procedurës penale, mbulohen nga mjetet buxhetore të kësaj Gjykate.
4. E dëmtuara KEDS, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.607/2022 (2022:0021739), të datës 29.04.2022, kundër të pandehurit M.S., për shkak të veprës penale: Vjedhje e shërbimeve, nga neni 314, par.6, e lidhur me par.1, të KPRK-së.

Pas pranimit të lëndës dhe marrjes se veprimeve përkatëse, siç konstatohet në shkresa e lëndës, dhe vlerësimit, gjyqtari i çështjes ka vlerësuar se është e domosdoshme plotësimi i lëndës nga ana e Prokurorit të Shtetit, pasi që aktakuza e prokurorisë, e datës 29.04.2022, nuk përmban elementet e domosdoshme për të mundur që gjykata të veprojë më tutje me procedurën në këtë çështje penale. Kjo për fakin se, fillimisht të dhënat personale për të pandehurin nuk janë të plota,

mungon dokumenti kyq dhe elementar siq është kopja e letërnjoftimit, nga i cili rrjedhin të dhënat e plota dhe të sakta, por edhe të dhënat e tjera. Përveç kësaj, përshkrimi i gjendjes faktike të aktakuzës nuk i përmban të gjitha elementet e figurës së veprës penale, ashtu siç kërkohet në nenin 241, par.1 dhe 2, të KPP-së, ku prokuroria e ka ngritur aktakuzën pa zhvilluar asnjë veprim hetimor, pa u grumbulluar asnjë provë, nuk është marr në pyetje asnjë dëshmitar, prokuroria nuk e ka ndërmarrur asnjë veprim hetimor, por vetëm janë përcjellur provat e bashkangjitura nga ana e të dëmtuarës, e përveç kësaj, aktakuza ishte ngritur pa i dhënë mundësinë të pandehurit që të deklarohet në procedurën paraprake, obligim ligjor ky sipas nenit 132, par.1, 132, par. 2 e 6, dhe neni 151, par.1, të KPP-së.

Meqenëse kjo aktakuzë përmban të metat e cekura si më lartë që të veprohet më tutje, Gjykata, me datë 26.05.2022, duke u bazuar në nenin 442, par.4, të KPP-së, ka kërkuar nga prokurori i shtetit plotësimin dhe korrigjimin e aktakuzës, duke e njoftuar me pasojat e mosveprimit në drejtim të plotësimin. Nga shkresat rezulton se prokuroria, shkresën për plotësim dhe korrigjim e ka pranuar më datë 30.05.2022.

Prokuroria, brenda afatit ligjor prej 30 ditëve nuk e ka plotësuar aktakuzën sipas kërkesës së Gjykatës, dhe nuk ka kthyer kurrfarë përgjigje.

Gjykata, duke qenë se prokuroria nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për të vepruar sipas vërejtjeve, ka konstatuar se prokuroria në raport me të pandehurin M.S., nuk ka zbatuar dispozitat e nenit 241, par.1 dhe 2, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, sepse nuk ka zhvilluar asnjë hetim penal konkret ndaj të pandehurit. Kështu, kallëzimi penal nga ana e KEDS – it, është paraqitur me datë 29.03.2022, ndërsa aktakuza është ngritur më datë 29.04.2022, dhe gjatë kësaj periudhe nuk ka ndërmarrë asnjë veprim hetimor të përcaktuar nga KPP-ja, me qëllim të vërtetimit sa më të drejt të fakteve konkrete.

Përkundër që, për këtë vepër penale aktakuza mund të ngritet edhe pa nxjerr aktvendim për fillimin e hetimeve, prapëseprapë, është detyrim ligjor i prokurorisë që të pandehurit t'i epet mundësinë e deklarimit para ngritjes së aktakuzës. Këtë detyrim e përcakton neni 151, par. 1 i KPP-së, i cili përcakton: *“Para ngritjes së aktakuzës, i pandehuri merret në pyetje në seancën e marrjes së deklaratës në procedurë paraprake. Nëse i pandehuri hetohet për vepër apo vepra penale për të cilat dënimi maksimal i paraparë është jo më shumë se tre (3) vjet burgim, mjafton që të pandehurit t'i jepet mundësia që të përgjigjet me shkrim”*. Pra, referuar shkresave, prokuroria asnjëherë nuk ia ka dhënë mundësinë të pandehurit që të deklarohet në lidhje me këtë çështje penale, por që në këtë mënyrë aktakuza është ngritur pa u njoftuar fare lidhur me veprën penale që i vihet në barrë, e drejtë kjo e garantuar për të pandehurin sipas Kodit të Procedurës Penale.

Përveç kësaj, aktakuza e ngritur ka qenë në kundërshtim edhe me nenin 103, par. 1 dhe 2, të KPP-së, sipas të cilave, qëllimi i hetimit është të mblidhen provat dhe të vendoset për ngritjen e akuzës apo pushimin e hetimeve në mungesë të provave. Ndërsa, në rastin konkret, nga kallëzimi penal, më datë 29.03.2022 e deri më datë 29.04.2022, kur është ngritur aktakuza, në shkresat e lëndës nuk rezulton asnjë veprim hetimor.

Neni 442 par. 4 i KPP-së, përcakton: *“Nëse me këtë Kod nuk është paraparë ndryshe, gjykata thërret paraqitësin e parashtresës së pakuptueshme ose që nuk përmban atë që është e nevojshme që të mund të veprohet në bazë të saj, që ta korrigjojë apo ta plotësojë parashtresën, e nëse ai nuk e bën këtë brenda afatit të caktuar, gjykata e hudh poshtë parashtresën”*.

Duke qenë se prokuroria, përkundër kërkesës së Gjykatës që ta plotësoj dhe korrigjojë aktakuzën e lartcekur, nuk ka eliminuar asnjë prej mangësive të lartcekura, respektivisht nuk ka vepruar sipas kërkesës, atëherë, Gjykata, në mbështetje të nenit 442, par.4, të KPP-së, e ka hedhë poshtë aktakuzën PP.II.nr.607/2022 (2022:0021739), të datës 29.04.2022, ndaj të pandehurit M.S..

Gjykata në këtë rast iu ka referuar edhe praktikës së Gjykatës së Apelit, ku në një rast, respektivisht në rastin PN.nr.1005/20, e ka refuzuar ankesën e prokurorisë duke e vërtetuar aktvendimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë, datë 27.11.2020, me të cilin Aktvendimi ishte hedhur aktakuza e prokurorisë për shkak të mosplotësimit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, në lidhje me marrjen e deklaratës nga i pandehuri, ku edhe Gjykata e Apelit ka konstatuar se aktakuza në këtë rast është ngritur në kundërshtim me nenin 241, të KPP-së, pasi që të pandehurit nuk i është dhënë mundësia që të dëgjohet në procedurë para ngritjes së aktakuzës. Gjithashtu, në një rast pothuajse tërësisht të ngjashëm, Gjykata e Apelit me Aktvendimin PN.nr.1090/2021, datë 21.01.2022, e ka refuzuar ankesën e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë dhe e ka vërtetuar Aktvendimin P.nr.370/2021, datë 20.08.2021, në të cilin rast ishte hedhur aktakuza për arsyen se prokurori i shtetit nuk kishte vepruar sipas kërkesës së Gjykatës për plotësimin e aktakuzës, për arsyet e njëjta, pra për faktin se të pandehurit nuk i ishte dhënë mundësia të deklarohet për çështjen e tij në asnjë fazë të procedurës penale.

Gjykata në këtë çështje e ka hedhur poshtë aktakuzën si të pa plotësuar dhe të pa korrigjuar, që nënkupton se prokurori i shtetit mund të parashtroj aktakuzë pas plotësimeve dhe korrigjimeve të nevojshme që duhet të përmbajë aktakuza.

Në lidhje me kërkesën pasurore juridike, në kuptim të nenit 463, të KPP-së, pala e dëmtuar është udhëzuar në kontest civil.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale mbështetet në nenin 454, par.1, të KPP-së.

Nga ajo që u konstatua si më lartë, e në mbështetje të nenit 442, par.4, e lidhur me nenin 241, të KPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale mbështetet në nenin 454, par.1, të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.271/2022, datë 14.07.2022
2022:087568, 14.07.2022

Gjyqtari

Rrahman H. BEQIRI

KËSHILLA JURIDIKE; Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa e personave të autorizuar ne afatin prej 3 ditësh nga dita e pranimit, nëpërmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.